



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA THEMELORE PEJË**  
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

---

**P nr. 511/16**

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA THEMELORE NË PEJË D.P. , gjyqtari Sejdi Blakaj me sekretaren juridike Gjyljeta Çorkadiu , në lëndën penale kundër të pandehurit D. K , sipas aktakuzës së PTH-së D.P. në Pejë PP/II. nr.981/16 të dt.09.6.2016 për shkak të veprës penale: të vjedhjes nga neni 325 par 1 të KPRK-së pas përfundimit të shqyrtimit fillestar , publik dhe me gojë, të mbajtur në praninë të pandehurit D. K dhe të prokurorit të shtetit Sanije Gashi Seferi me dt.17.7.2017 ka marrë dhe botërisht ka shpallë këtë :

**A K T G J Y K I M**

**I pandehuri D.K i lindur me dt.11.7.1994 në Pejë rruga ----- nr. ---, ku edhe tani jeton, i biri i F dhe nënës S e gjinisë L, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës , gjendet në liri.**

**ËSHTË FAJTOR**

Për arsye se:

Gjatë muajit shkurt të vitit 2016 , në rrugën Lekë Dukagjini Komuna e Pejës , me qëllim të vetes ti sjellë përfitim pasuror në mënyrë të kundërligjshme ka përvetësuar pasurinë e luajtshme të të dëmtuarit N. B dhe atë një motoçikletë , në atë mënyrë që me dt. 04.4.2016 i dëmtuari përderisa ka qenë në vendin e lartcekur rastësisht ka vërejtur të pandehurin D. K. me motoçikletën e tij dhe menjëherë ka ndaluar dhe e ka identifikuar motoçikletën dhe ka lajmëruar policinë .

-me çka ka kryer veprë penale : të vjedhjes nga neni 325 par 1 të KPRK-së

Prandaj gjykata të pandehurin konform nenit 41, 42,43,46 ,49 ,50,51,52, 76 dhe nenit 325 par1 të KPRK-së.

**E GJYKON :**

1. Me dënim me gjobë në lartësi prej 200 euro , e të cilën gjobë i pandehuri fare nuk do ta paguaj nëse në afat prej 1( një )viti nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale .

Dhe :

**Me dënim burgu,**

2. Në atë mënyrë që ia përcakton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 6 muajsh , e të cilin dënim i pandehuri fare nuk do ta vuaj nëse në afat prej 1 viti nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale

Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 15 euro – 15 ditë pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë

I dëmtuari për realizimin eventuale e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Shpenzime procedurale nuk ka pasur

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë me dt.09.6.2016 kundër të pandehurit D.K, ka ngritë aktakuzë PP/II. nr.981/16, për veprë penale : të vjedhjes nga neni 325 par 1 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë të pandehurin ta shpallë fajtorë , ta dënoj sipas ligjit dhe ta obligoj në pagimin e shpenzimeve procedurale .

Në shqyrtimin fillestarë i pandehuri – pasi që paraprakisht i është lexuar aktakuza , është njoftuar me të drejtat dhe detyrimet procedurale dhe pasojat e pranimit përkatësisht të mos pranimi të fajësisë- e ka pranuar fajësinë dhe ka manifestuar keqardhje për atë që i ka ndodhur. Këtë pranim fajësie gjyqtari – pasi që paraprakisht e ka marrë pëlqimin e prokurorit të shtetit, i bindur se pranim fajësinë i pandehuri e ka bërë ashtu siç e parasheh ligji – vullnetarisht dhe pa u ndikuar nga askush dhe në asnjë mënyrë -e ka pranuar .

Meqenëse i pandehuri e pranoj fajësinë gjyqtari kaloj në marrjen e vendimit lidhur me llojin dhe lartësinë e masës ndëshkuese , me ç rast i pati parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese. Rrethanë rënduese në rastin konkret gjyqtari nuk ka gjetur , kurse nga ato lehtësuese ka çmuar : pranimin e sinqertë të fajësisë , pendimin e thellë për këtë gjë, qëndrimin korrekt në gjykatë, pa dënueshmërinë e mëparshme , faktin se i pandehuri është i gjendjes së varfër ekonomike, dhe kësaj gjyqtari mendon se edhe me një vendim si në dispozitivin e aktgjykimit ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me neni 41 të KPK-së .

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 të KPPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit në kontestin e rregullt civil është marrë konform nenit 463 të KPPRK-së .

Nga sa u tha më lartë konform nenit 365 të KPPRK-së u vendos si më lartë.

Nga Gjykata Themelore në Pejë D.P. datë. 17.7.2017

Sekretarja juridike  
Gjyljeta Çorkadiu

Gjyqtari  
Sejdi Blakaj

### KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi lejohet  
Ankesa në afat prej 15 ditësh nga  
Dita e marrjes , Gjykatës të Apelit në Prishtinë  
E përmes kësaj Gjykate .